



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASENIT LUMOR MAT

VENDIM

Nr.11, datë 29/12/2025

PËR

SHTYRJE E VENDIMARRJES E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE DHE PROCESE TEKNOLOGJIKE, TË SUBJEKTIT “BERALB” SH.A.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujur, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, vendimit nr. 6, datë 12.06.2019 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujur ” të Këshillit Kombëtar të Ujit, neni 20 gërma “c”, pas shqyrtimit të kërkesës , Këshilli Basenit Lumor Mat

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimarrjes për shqyrtim të mëvonshëm e “kërkesës për leje përdorimi burimi ujur sipërfaqësor për qëllime industriale dhe procese teknologjike”, të subjektit “BERALB” sh.a, për arsyet e mëposhtme:

-Duke qenë se subjekti është penalizuar për masa administrative, të kërkohej informacion nga Agjencia e Mjedisit dhe ARM në lidhje me inspektimet.

-Të kërkohej një qëndrim nga ana e njësisë vendore që e ka në territorin e saj subjektin.

2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

3. Të trajtohet në mbledhjen e radhës

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

KRYETARI I KBL MAT
TAULANT MALSHI

